

VENDIM
Nr.5, datë 7.1.2010

PËR REALIZIMIN E SHËRBIMIT FINANCIAR TË VLERËSIMIT TË RISKUT TË VENDORIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç” të nenit 7 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin dhe realizimin e procedurës, që do të ndiqet për zhvillimin e procesit të vlerësimit të riskut të vendit (Credit rating), për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

2. Termi “Vlerësim i riskut (Credit rating)” në kuptim të këtij vendimi, përfshin shërbimin financiar në formën e procesit vlerësues të riskut të vendit, duke ofruar shërbimin e nevojshëm për realizimin e procesit të transaksioneve të huamarrjes në tregun ndërkombëtar.

3. Për realizimin e shërbimit financiar, titullari nxjerr urdhrin, në të cilin duhet të përcaktohen, detyrimisht:

a) shërbimi financiar, objekt i kësaj procedure;

b) lista e institucioneve financiare pjesëmarrëse, që do të ofrojnë shërbimin e kërkuar, e cila do të përcaktohet nga komisioni i hartimit të dokumenteve;

c) përbërja dhe emrat e anëtarëve të komisionit të hartimit të dokumenteve dhe të komisionit të vlerësimit të ofertave, në përbërje të të cilit të jenë kryetari dhe të paktën 2 specialistë të fushës;

ç) çdo element tjetër i vlerësuar si i nevojshëm.

4. Komisioni i hartimit të dokumenteve, brenda 5 ditëve nga data e nxjerrjes së urdhrin, përgatit ftesën për ofertë, të cilën e dërgon në adresat përkatëse. Në ftesë përcaktohen:

a) institucioni, që kryen procedurën për shërbimin në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi;

b) shërbimin financiar, që kërkohet të realizohet;

c) kushtet e veçanta të kërkuara;

ç) data, ora dhe vendi i paraqitjes së ofertës.

5. Dokumentacioni i paraqitur nga subjektet e interesuara ruhet dhe nuk hapet nga komisioni i vlerësimit të ofertave deri në datën dhe orën e caktuar në ftesën për ofertë.

6. Komisioni i vlerësimit të ofertave, në marrjen e vendimit përfundimtar për përzgjedhjen e subjektit, bazohet, respektivisht në:

a) plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe teknike;

b) cilësinë e shërbimit të ofruar dhe reputacionin në tregjet financiare më të njohura botërore;

c) çmimin më të ulët për shërbimin e ofruar nga subjektet, për blerjen, shitjen/transferimin e instrumentit financiar.

Rëndësia e secilit prej kriterëve të sipërpërmendura do të përcaktohet në dokumentet e tenderit, gjë për të cilën do të njoftohen institucionet financiare pjesëmarrëse.

7. Titullari i institucionit, në bazë të vendimit të dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertave, miraton ose refuzon, brenda 5 ditëve, shpalljen e fituesit.

8. Komisioni i vlerësimit të ofertave, brenda 5 ditëve nga shpallja e fituesit, njofton të interesuarit për klasifikimin përfundimtar të ofertave.

9. Ankesat e subjekteve ndaj procedurës së zhvilluar i paraqiten, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit, titullarit të institucionit. Vendimi i jepet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës dhe është përfundimtar. Njoftimi përfundimtar i fituesit do të bëhet me të gjitha mjetet e komunikimit.

10. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha